



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 262/2024

Datë: 19 mars 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 dhe nenit 28 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe neni 10 i Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 19 mars 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Z. Arben Ismajli, prokuror në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë e Apelit, transferohet në mënyrë të përhershme në Prokurorinë Speciale nga data 01 prill 2024.
- II. Z. Ismajli ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Prokurorinë Speciale.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 10 janar 2024 ka pranuar një kërkesë nga Prokurori i Shtetit z. Arben Ismajli, për transferim nga Prokuroria e Apelit në Prokurorinë Speciale.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur me datë 19 mars 2024 me shumicë të votave vendosi për transferimin e tij në Prokurorinë Speciale.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Arben Ismajli, prokuror në Prokurorinë e Apelit;
- Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit;
- Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së,